

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI : *REHABILITIMI I QENDRES*

SE FSHATIT “BRATAJ”



SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse

1.1.2 Punime të gabuara

1.1.3 Tabelat njoftuese

1.2 Dorëzimet te Supervizori

1.2.1 Autorizimet me shkrim

1.2.3 Mostrat

SEKSION 2 PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1 Punime prishjeje

2.1.1 Metoda e prishjes

2.1.1 Siguria në punë

2.2 Heqja e dyerve dhe dritareve

2.1.1 Heqja e zgarave metalike aty ku ekzistojne

SEKSIONI 3 PRISHJA E CATISE DHE NDERTIMI CATISE SE RE

3.1 Te dhena te pergjithshme

SEKSIONI 4 RIFINITURAT

4.1 Rifiniturat e mureve

4.1.1 Suvatimi i brendshëm në rikonstruksione

4.1.2 Suvatim i jashtëm në rikonstruksione

4.1.3 Lyerje me bojë plastike në rikonstruksion

4.1.4 Veshja me pllaka

4.2 Rifiniturat e dysHEMEVE

4.2.1 DysHEME ME PLLAKA GRES

4.3 DYER DHE DRITARE

4.3.1 DRITARET/INFORMACION I PËRGJITHSHËM/KËRKESAT

4.3.2 Komponentët

4.3.3 Dritare duralumini

4.4 DYERT - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

4.4.1 Dyert - Vendosja në vepër

SEKSION 5 PUNIMET ELEKTRIKE

5.1 Specifikime elektrike të veçanta

5.1.1 Aksesorët (të përgjithshme)

5.1.2 Tela dhe kablllo

5.1.3 Kanalet dhe aksesorët

5.1.1 Kutitë shpërndarëse

5.1.5 Lidhjet fleksible

5.1.6 Llambat dhe ndriçuesit

5.1.7 Llambat fluoreshente

5.1.8 Çelësat e ndriçimit

5.1.9 Prizat

5.2 Sistemi i tokëzimit

SEKSIONI 6 INSTALIMET MEKANIKE, HIDRAULIKE DHE SANITARE

6.1 Sistemi i furnizimit me ujë të pastër

6.1.1 Tuba

6.2.1 Rakorderitë për tubat e ujit të pijshëm

6.2.2 Saraçineskat

6.3 Pajisjet Hidrosanitare

6.3.1 WC dhe kasete e shkarkimit

6.3.2 Lavamanet

6.3.3 Rubinetat



SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Specifikime të përgjithshme

1.2.2 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

Kontraktuesi duhet t'i japë supervisorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervisor, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervisor gjatë zbatimit të punimeve.

1.1.3 Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.1.4 Tabelat njoftuese

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervisor dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

1.2 Dorëzimet te Supervisor

1.2.1 Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim ” do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervisor të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

1.2.2 Dorëzimet tek supervisor

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervisorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervisor.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, certifikata testi, kurdo që të kërkohen nga Supervisor. Supervisor do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervisorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervisorit për të bërë këto pranime.

1.2.3 Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkojnë me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

SEKSION 2 PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.2 PUNIME PRISHJEJE

2.2.1 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e nevojshme.

2.2.2 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me eksperiencë
- b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

2.2.3 Prishja e murit te gurit

Muri I gurit do te priset me kujdes qe te mos jete rrezik per punetoret duke e prishur nga siper ne drejtim te themelit .

2.2.4 Heqja e mbeturinave te prishjes se murit.

Do te konsistoje ne heqje e mbeturinave te prishjes se murit me eskavator 0.25 m3 dhe ngarkimin ne mjet duke e evaduar materialin ne vendin e hedhjes se mbeturinave te ndertinit te caktuara nga njesia administrative per fshatin Brataj.

Gjate punes se eskavatori punonjesit duhet te qendrojne jashte rrezes se punes se eskavatorit.

SEKSIONI 3 NDERTIMI I MURIT

3.3 Ndertimi murit dekorativ

3.3.1 Ndertimi themeli butobeton C12/15

Para hedhjes se betobit pastrohet siperfaqja e themelit te hapur. Hidhet betony I markes C12/15 qe pergatitet me 0.49 m³ rere te lare ,0.77 m³ zall, 245 kg cimento 32.5 N dhe uje 200 litra. Pas hedhjes se betonit behet bngjeshja e tij me vibrator thellesie.

3.3.2 Brez b/a C16/20

Përpara se të hidhet betony c16/20 pergatiten kallepet e drurit te brezit mbi mure .Pas kontrollit te kallepeve kontrollohet armature e hekurit. Para hedhjes se betonit laget siperfaqja e murit te gurit ku do te hidhet betony dhe pastaj hldhet beton C16/20 dhe ngjishet me vibrator .Betoni C16/20 do te jete me dozaturat 0.47 m³ rere te lare ,0.76 m³ zall, 286 kg cimento 32.5 N dhe uje 200 litra.

Para fillimit te ndertimit te murit te gurit ngrihen drejtuesit vertikale per te vendosur spangot per te ruajtur ndertimin vertikal te murit. Perdoret guri ne former rasa te zones i cili duhet te jete i pastruar nga mbeturinat si dhera e tjere dhe pastaj te vendoset ne objekt me ll.b.M.25. Muri ndertohet me ll.b.M.25i cili ka perberesit rere 1.01 m³ , gelqere e shuar 87.kg , cimento 32.5 N 206 kg.

3.3.3 Veshje me gure dekorativ tek dyert (korniza , koloncina , harqe.

Guri i zones qe do te perdoret per veshje do te jet I prere me trashesi 2~3 cm dhe i prere ne forma te rregullta sic tregohet ne projekt. Guret vendosen ne objekt me ll.c.1:2. Llaci I cimentos ka perberjen e meposhtme ; rere e lare 0.89 m³ cimento 32.5 N 527 kg. Para vendosjes s e pllakave siperfaqja lahet e pastrohet.

3.3.4 Porta druri me punim dekorativ.

Portat e drurit prodhohen sipas projektit te dhene .Druri qe prodhohen dyert duhet te jete pishe e staxhionuar I cili lyhet mire me vaj lini. Pas prodhimit behet montimi I dyerve ne objekt ku rendesi duhet ti kushtohet kapjes se kanatit me kasen ne menyre qe dera te mos pesoje varje dhe te veshtiresohet ne hapje.

3.3.5 Kangjella metalike me punim dekorativ.

Kangjellat metalike do te pergatiten rigorozisht sipas forms se projektit. Saldimi I elementeve do te behet me elektroda te buta E42. Lartesia e tegelit te saldimit merret sa ai konstruktiv 6 mm. Sadimi behet gjate te gjithe gjatesise se kontaktit te takimit te elemnteve. Para lyerjes me dy duar boje antiruxho e dy duar boje vaji siperfaqja e metalit pastohet mire me furce teli.

SEKSIONI 4 PUNIMET NE RRUGE

4.4.1 Germimi me eskavator 0.25 m³ shkemb I coptuar

Germimi parashikon germimin e trasese ku perfshihen shtresat e rruges qe nga asfalti e Nenshtresat si dhe ngarkimin e tyre ne mjet. Per kete arsye eshte konsideruar germimi si shkemb i coptuar.

4.4.2 Transport dheu me automjet deri ne 2 km.

Dheu transportohet me automjetet qe ngarkohen ne objekt deri ne vendin e shkarkimit te mbeturinave te caktuara nga njesia administrative per fshatin Brataj qe ne rastin tone eshte marre deri ne 2 km largesi nga vendi i punes.

4.4.3 Shtrese zhavori 20 cm ngjeshur me makineri.

Parashikohet marrja e transporti I materialit nga kavoje ne vendin e transportit. Ne objekt zhavori shperndahet me makineri ne shtresa 2x10 cm dhe behet ngjeshja e tij me vibro rul. Granulometria e zhavorit duhet te jete 0~60 mm.

4.4.4 Shtrese cakelli 20 cm ngjeshur me makineri.

Parashikohet marrja e cakellit nga nyja e prodhimit ne objekt. Cakelli duhet te jete me granulometri 0~40 mm. Shperndarja e tij ne objekt behet me makineri ne shtresa 2x10 cm dhe behet ngjeshja e tij me vibro rul.

4.4.5 Shtrese stabilizanti 10 cm.

Stabilizanti vjen ne objekt dhe shperndahet me makineri ne trashesi 10 cm dhe ngjeshet me Vibro rul.

4.4.6. Shtrese binderi 6 cm me gure kave.

Binderi duhet te kete perberjen 0.36 m³ granil I thyer , 0.24 m³ rere e lare dhe bitum 49 kg per nje ton asfalt. Binderi duhet te vij ne objekt ne temperature me te madhe se 110 grade Celsius. Para hedhjes se binderit behet sperkatja e siperfaqes se stabilizantit me emulsion bituminoz 0.5 l/m²

4.4.7 Shtrese asfaltobetoni 5 cm me gure kave.

Asfalto betoni do te kete perberjen ; granil guri I thyer 0.29 m³ , rere e lare 0.24 m³ , bitum 68 kg per nje ton asphalt. Asfalti duhet te vij ne objekt ne temperature mbi 110 grade Celsius. Asfalti shperndahet me makineri sipas pjerresise se rruges dhe ngjeshet me makineri.

4.4.8. Struktura monolite betoni.

Strukturat monolite te betonit hidhen sipas projektit ne neshtresa kuneta e tjere sipas trashesise e kuotave te caktuara. Perberja e betoneve eshte si me poshte :
Betoni C12/15 rere 0.49 m³ , zall 0.77 m³ , cimento 32.5 N 245 kh , uje 200 litar
Betoni C16/20 rere 0.47 m³ , zall 0.76 m³ , cimento 32.5 N 287 kg , uje 200 litra
Betoni C20/25 rere 0.47 m³ , zall 0.76 m³ , cimento 32.5 N 298 kg , uje 200 litra
Ne shtresat e betonit te trotuareve para hedhjes se betony vendosen mastaret e nivelimit te cilat vendosen ne kuotate caktuar dhe vendosen me instrument mates.

4.4.9 F,V. bordure guri 20x35 cm.

Pergatiten guret e zones sipas forms se bordurit ne piken e perpunimt te gurit dhe pastaj transportohet ne objekt.vendose bordurat mbi shtresen e betonit me ll.c.1:4 duke mbajtur drejtimin e vendosur te tyre. Fugat midis bordurave njera pas tjetres mbushen me ll.c.1:4.

4.4.10 Trotuar me 6 cm beton me pllaka guri 6 cm.

Pllakat qe perdoren jane me trashesi 6 cm dhe me dimensione 20x20 cm te cilat pergatiten sipas projektit ne nyjen e prodhimit te gurit.para vendosjes se pllakave te gurit behet shtresa e betonit 6 cm me beton C16/20 sipas kuotave te projektit. Pas tharjes se shtreses se betonit vendosen pllakat e gurit me rere 4 cm sipas konfiguracionit te dhene ne projekt.

4.4.11 Shtrese me pllaka guri mbi rere.

Kjo shtrese perdoret ne trotuaret qe kane parkime makinash te vogla . Pllakat e pergatitura ne nyjen e prodhimit vijne ne objekt dhe montohen mbi shtresen e reres sipas konfiguracionit te dhene ne projekt.

4.4.12 Vizimet me boje bikomponente.

Vizimi me boje komponente behet ne vendet e kalimit te kembesoreve kurse vizimi me boje komponente 15 cm behet per ten dare korsite e rrugeve dhe vendet e parkimit. Ne rastin tone perdoret vetem ne ndarjen e korsive te rrugeve.Para lyerjes me boje bikomponente pastrohhet siperfaqja e asfaltit nga papstertite e pastaj behet lyrja e siperfaqes .Normativat e harxhimit ja ne 0.5 kg/m2 per lyerjen me boje bikomponente dhe 0.1kg/ml per lyerjen me boje bikomponente 15 cm.

SEKSIONI 5 PUNIMET E NDRICIMIT

5.5.1 Punimet e rrjetit te tubacionit korelato O 63mm

Tubacioni vendoset mbi nje shtrese rere dhe mbulohet me rere. Trashesia e shtreses se reres merret gjithsej 20 cm.

Tubacioni futen ne thellesi 70 cm ne aks dhe thellesia e keneli behet 80 cm.pjesa mbi rere mbushet me zhavor dhe pjesa tjeter jane shtresat e trotuarit.Kanali behet 80 cm l thelle se kalon ne trotuarin qe sherben per parking.

5.5.2 Vendosja e shtyllavete ndricimit.

Shtyllat dekorative me dy krahe me lartesi 3 m vendosen mbi bazamente betoni C16/20 me dimensione 70x70x100 cm. Shtylla kapet me bazamentin me prixhionier O 16 mm sic tregohet ne vizatimin perkates.

5.5.3 Puseta elektrike kontrolli 40x40x40cm.

Prane cdo shtylle vendoset pusete kontrolli 40x40x40 cm ne te cilat kalon kablli kryesor 4x4mm² dhe ne to behet dhe lidhja ekablilit 4x1.5 mm² qe shkon ne llampat e ndricimit.Ne anet e hapura te pusetave ku hyne kabllot vendoset woterstop qe te mos lejoje hyrjen e ujit nga ambient l jashtem ne pusete.

5.5.4 Kabllot elektrike.

Furnizimi me energji elektrike behet nga shtylla e tensionit.Linja marrese e shte 4x10 mm² dhe hyn ne kuadrin elektrik ku jane montuar leshuesit , automatet e mbrojtjes diferenciale ,timerat e

kohes e te tjera. Linja nga kuadri elektrik deri tek shtylla e pare eshte kabell 4x10 mm².
Linja qe furnizon shtyllat njera pas tjetres qe kalon ne cdo pusetete eshte kabell 4x4 mm².
Linjat nga pusetat deri tek ndricuesit eshte kabell 4x1.5 mm².
Te gjitha kabllot bashkohen me njera tjetren me kapikolta sipa diametrave te fijeve te kabllit.

5.5.5 Tokezimi

Ne cdo shtylle vendoset elektrode tokezimi ecila lidhet me sistemin me percjelles tokezimi bakri te Xhveshur me diameter O 35mm²

Elektrodat e tokës do jenë me një profil L, të galvanizuar çeliku 50x50x5mm (ose me elektroda togëzimi të zinguara) të futura në një thellësi minimale prej 2 metrash. Numri i elektrodave të togëzimit varet nga lloji I truallit dhe nga ajo qe Rt (rezistenca e togëzimit), e cila duhet të jetë më e vogel se 4 Ω. Për këtë pas përfundimit të vendosjes së elektrodave duhet bërë matje me aparat të Rt dhe të mbahet një proces verbal, I cili duhet t'i paraqitet Supervizorit. Në rast se Rt është më e madhe se 4 Ω, atëherë duhet të shtohet numri i elektrodave deri sa të arrihet ajo e kërkuara.

Ark.Arben GOLEMI
Ing.Kon.Reshit BEDHIA

